

Komuna e Pejës/Peć

Milan (Vaso) Radanović

(7.07.1946, serb nga Peja/Peć, bujk, i pamartuar)

Milani me vëllain Nikolen dhe familjen e tij kanë jetuar në fshatin Çremushnicë [Kroaci] deri në muajin gusht të vitit 1995. Në datën 4.08.1995, kur Kroacia e nisi fushatën *Oluja/Stuhia*, ai me farefisnin në kuadrin e kolonës së refugjatëve kanë kaluar në Serbi. Te vendi Shimanovce, Milani u nda nga i vëllai dhe me disa refugjatë të tjerë u nisën me autobus për në Kosovë. Më vonë, Nikola ka mësuar se Milani ishte strehuar në qendrën e strehimit pranë Shkollës Ekonomike në **Pejë/Peć**. Komshiu i tyre nga Çremusnica, Pero Radanović, ka qenë së bashku me Milanin në qendrën e strehimit deri në vitin **1998**. Nga ajo kohë, askush nuk e kishte parë kurrë më Milanin. Zhdukja e tij është evidentuar nga KNKK-ja, në lëndën që e mban numrin rendor BLG-803980-01.

Burimet: deklarata N.R, FDH-36590; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795.

Qerim (Ukë) Muriqi

(10.04.1946, shqiptar nga Peja/Peć, gjellëbërës, pesë fëmijë)

Në datën **18.03.1998**, partitë politike shqiptare kanë organizuar demonstratat kundër pushtetit serb në shumicën e qyteve të Kosovës. Qerimi me vajzat Besarten, Nevryzen dhe Mirlinden kanë marrë pjesë në demonstratat në **Pejë/Peć**. Përderisa qëndronin në mesin e demonstrueseve, rreth orës 11:15, dikush ka shtënë mbi Qerimin nga ballkoni i ndërtesës së afërme. U qellua në gjoks. Nderroi jetë në rrugë për

në spital. Varrimi i Qerimit u bë në varrezat myslimane në Pejë/Peć, me pjesëmarrjen e disa mijëra njerëzve, më 19.03.1998.

Burimet: deklarata B.M, FDH-15096; *Albanian marchers clash with Serbs in Kosovo*, CNN, 19.03.1998, FDH-20077; *Monitoring Kosovo: local media reports*, BBC, 19.03.1998, FDH-20078.

Çelë (Shaban) Desku

(10.07.1957, shqiptar nga Kliçina/Klinčina, komuna e Pejës/Peć, teknik i mekanikës, gjashtë fëmijë)

Çelë Deskun e kanë vrrarë në **Kliçinë/Klinčina** më **24.04.1998**. Atë ditë, rreth orës 10:00, fëmijët e tij e çuan bagëtinë në kullotë. Një orë më vonë, u dëgjuan disa të shtëna dhe ai doli jashtë të shihte çfarë po ndodhte me fëmijët. Por, pas pak, fëmijët u kthyen në shtëpi, por nuk e gjetën të atin aty. Rreth orës 18:30, banorët e fshatit i lajmëruan bashkëshortes për vrasjen e tij. Policia serbe e ka çuar trupin e tij në spitalin e Pejës/Peć. Të nesërmen, policia e ftoi familjen që ta merrte trupin e tij. E varrosën në varrezat e Kliçinës/Klinčina më 26.04.1998.

Burimet: deklarata H.D, FDH-14006; KMDLNJ, *Buletini*, num.7, prill-qershor 1998, 143, FDH-23816; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817; KMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; SMIP, *Teroristički...*, III, 910; *Teroristi muçili i ubili 67 nedužnih civila*, Politika, 14.9.1998, <http://www.arhiva.srbija.sr.gov.yu/vesti/1998-09/17/5250.html>.

Skënder (Dinë) Krasniqi

(15.11.1966, shqiptar nga Peja/Peć, i papunë, pesë fëmijët)